



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS

ZYRA SHQIPTARE PËR TË DREJTËN E AUTORIT

## Njoftim për shtyp

**Konkurs Kombëtar më sistemin Universitar në Republikën e Shqipërisë**

FAZA FINALE

### ***“PIRATERIA DËMTON KULTURËN DHE INTEGRITETIN E NJË KOMBI – TË RESPEKTOJMË TË DREJTËN E AUTORIT NË SHQIPËRI”***

**Më datë 24 prill 2015 në ora 9:00 në sallën e Black Box, në Universitetin e Arteve** do të zhvillohet faza finale e konkursit kombëtar për të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura.

Në kuadër të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale, ditë e cila festohet në mbarë botën nga shtetet anëtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale çdo 26 prill, Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit, ka zhvilluar gjatë gjithë muajit prill, aktivitete të ndryshme për të sensibilizuar dhe ndërgjegjësuar shoqërinë shqiptare me koncepte dhe çështje të të drejtës së autorit.

Pikërisht në këtë ditë, ndër të tjera ZSHDA vendosi të organizojë një Konkurs Kombëtar me gjithë shkollat e sistemit universitar, në gjithë Republikën e Shqipërisë, bazuar në njohuritë për të drejtën e autorit dhe çështjeve të caktuara të lidhura me të, me sloganin ***“Pirateria dëmton kulturën dhe integritetin e një kombi – Të respektojmë të drejtat e Autorit në Republikën e Shqipërisë”***. ***Eksperiencia e mëparshme me sistemin e arsimit para-universitar dha rezultate të kënaqshme dhe pozitive. Pritshmëritë dhe për këtë konkurs mbeten maksimale.***

Aktiviteti zhvillohet nga Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve, si dhe Stafet Akadematike të çdo Universiteti në Tiranë dhe në Rrethe por dhe me mbështetjen e Qendres Ndërkombëtare të Kulturës “Arbnori”, Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë dhe Microsoft /Slloveni.

Edukimi dhe informimi për gjeneratën e re që po rritet sjell uljen e nivelit të piraterisë dhe shkeljeve në një vend të caktuar, eksperiencë kjo e provuar në shumë vende të zhvilluara. Ndërgjegjësimi i komunitetit dhe i shoqërisë në tërësi si dhe arsimimi në këto çështje, janë ndër shtyllat kryesore të Strategjisë Kombëtare të Zbatimit të të Drejtave të PI 2010-2015.

Sa më i madh të jetë informimi i konsumatorit për rëndësinë dhe rolin e të drejtave të PI-së, aq më i ulët do të jetë niveli i piraterisë dhe shkeljeve të tjera në vend.

Misioni i çdo qeverie të çdo vendi të botës është që kultura dhe prodhimtaria intelektuale vendase të zhvillohet, përhapet, promovohet e stimulohet, nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave efikase në funksion të respektimit të mbrojtjes së produktit intelektual.

Shqiperia e viteve te tranzicionit dhe Shqiperia e sotme qe zhvillohet dhe synon te jete pjese e familjes Europiane, has veshtiresi ne me shume se gjithshka ne mungesen e edukimit historik te brezave me kete nocion.

Shumë shtete të Bashkimit European kanë një platformë ku shpjegohet rëndësia jetësore e së drejtës së autorit në ekonominë e një shteti. Qeveri të shumë vendeve të zhvilluara sigurojnë në shkolla paketa të caktuara dhe materiale informative që ato i përdorin për të mësuar nxënës dhe të rinj rreth të drejtës së autorit dhe të mirat dhe përfitimet që burojnë nga kjo e drejtë. Jemi duke lobuar fuqishëm ne Ministrine e Arsimit që të futet në kurikul e drejta e autorit, si një lëndë më vete që në klasat e para të shkollimit.

Dhe pa dyshim krahas nje shteti ligjor, ku sundimi i ligjit eshte parim thelemelor i funksionimit te tij, nuk mund te anashkalojme dhe nevojën shume te madhe te informimit qe ka e gjithë shoqëria shqiptare. - Kjo mbetet nje sfide per ne.

Andaj një ndër qëllimet prioritare të Zyrës sonë ka qënë ndërgjegjësimi i shoqërisë në tërësi dhe edukimi i brezave që rriten. ZSHDA ka kryer disa fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete të tjera kryesisht me brezin e ri, të cilat kanë patur impaktin e tyre pozitiv ne fushën e te drejtës së autorit.

Pronësia Intelektuale shqiptare, si pjesë e qënësishme e kulturës kombëtare, është dhe do të jetë në fokusin e Qeverisë Shqiptare dhe të Ministrisë së Kulturës, për të përmbushur misionin dhe objektivin e saj, atë të vendosjes së kulturës, në shërbim të mirëqënies, zhvillimit dhe integritetit europian të Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Ka një vullnet të shprehur qartë të Qeverisë Shqiptare se respektimi dhe mbrojtja e të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të tjera të lidhura me të do të garantohet në të njëjtin nivel që garantohet në të gjitha vendet e zhvilluara të botës. Kjo fushë është prioritare për Qeverinë Shqiptare për të plotësuar të gjitha kushtet që kërkon BE, në mënyrë që të jemi vend anëtar me të drejta të plota.

Gjatë fazës finale të konkursit do të shpërndahen çmime simbolike dhe çertifikata për vendin e parë, të dytë dhe të tretë si dhe mjaft broshura informative dhe mjete të tjera promocionale.

Aktivitetin do ta përshëndesin Zv. Ministri i Kulturës, Z. Zef Çuni, Zv. Ministri i Arsimit dhe Sportit Z. Mazniku, Z. Petrit Malaj, Rektor i Universitetit te Arteve, dhe Z. Nikolin Jakaj, Kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Tiranë.

*ZYRA E SHTYPIT*